



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **36**

Prishtinë, më 12.2.2019, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Salih Zyba dhe Danush Ademi.

Munguan: Salih Salihu, Liburn Aliu, Sërgjan Mitroviq, Etem Arifi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Imeri dhe Sulltane Gashi. *(keta zyrtarë e kanë mbështetë mbledhjen, pasi që stafi i komisionit ka munguar)*

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja 28.1.2019;
3. Agjenda e projektligjeve në komision që kanë kaluar leximin e parë dhe caktimi i grupeve punuese;
4. Informata lidhur me grantet e Ministrisë së bujqësisë, të ftuar zv. Ministri dhe Sekretari i Ministrisë;
5. Përgjigjet nga OEK pas vizitës së anëtarëve të komisionit në këtë institucion,
6. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Salih Zyba kërkoi fillimisht sqarime të nevojshme pasi nuk janë prezent të ftuarit për këtë mbledhje. **Kryetari** njoftoi se menjher pasi është kërkuar njoftimi nga MB për shqetësimet e komisionit rreth granteve, të nesërmen është shkarkuar Ministri i MB, kurse nga zyrtarët e ministrisë është dërguar raporti me shkrim për shqetësimin e komisionit rreth granteve të cilin komisioni mund të studijoj pastaj të ftoj ministrin e ri që do të emërohet apo zyrtari tjetër kompetent, javën që vjen. Gjithashtu kryetari njoftoi se në bisedë me zv. Ministrin dhe Sekretarin e MB u njoftua se arsyeja pse këta zyrtar nuk prezentojnë në komision sot është se Kryeministri duhet të emëroj zëvendësin e Ministrin të shkarkuar, ndaj propozoi që kjo pikë të bartet në mbledhjen e radhës. **Salih Zyba** megjithatë konsideroi shqetësim këtë njoftim, ngase ky njoftim vjen në ditën e mbajtjes së mbledhjes pasi që faktet e kërkuara mund të raportohen edhe nga zyrtari

tjetër siç është zëvendës ministri, komisioni mund të shtyjet por ndërkohë krijohen skandale të reja, të pranohet me lehtësi ky arsyetim dhe vetëm raportimi me shkrim, nuk mjafton, përfundoi. **Ganimete Musliu** arsyetoi brengën e z. Zyba por komisioni duhet të vazhdoi punën për çka propozoi që menjher pas mbledhjes ti dërgohet shkresa Kryeministrit për të caktuar zyrtarin përgjegjës për këtë ministri i cili do të përgjigjet komisionit për çështjet ajo që kërkon. **Kryetari** u përgjigj se me zyrtarët e MB ka biseduar por nuk ka mandat për ti detyruar për ardhje në komision, u pajtua se duhet të shkruhet Kryeministrit ashtu si propozoi zj. Musliu. **Besa Gaxherri** nuk e arsyetoi këtë veprim të MB ngase qysh nga fillimi ky ministër i shkarkuar nuk ka dhënë llogari kësaj qeverie, poashtu kritikoi stafin për mosdërgimin e raportit në fjalë me shkrim për sot. **Kryetari** njoftoi se mungesa e stafit të komisionit në mbledhjen e sotme dhe zëvendësimi me tjetër staf megjithatë i ndryshon disa çështje për shkak të lidhjes teknike që ka. **Salih Zyba** potencoi faktin se opinioni është njoftuar nga mediat për shqetësimet e komisionit, prandaj me rëndësi është a kanë konfirmuar këta zyrtar pjesmarrjen për sot. **Kryetari** u përgjigj se sot është njoftuar nga zyrtarët e MB që nuk mund të marrin pjesë në mbledhje, pyeti komisionin kush është për ta kaluar këtë pikë për mbledhjen e radhës. **Salih Zyba** pyeti për cilin datë caktohet mbledhja dhe a do të pret komisioni konfirmim nga zyrtarët e MB, ngase çdo shtyerje e komplikon këtë situatë të krijuar. **Kryetari** përfundoi diskutimet duke propozuar që kjo pikë të bartet për mbledhjen e radhës : ose të caktohet nga Kryeministri zyrtari kompetent ose të vij personalisht në komision. **Ganimete Musliu** kërkoi të caktohet nga kryeministri periudha deri kur caktohet ky zyrtar, ngase komisioni sot cakton mbledhje por mbetet prapë enigma e ardhjes së tyre. **Kryetari** : ne po insistojmë për javën që vjen, kurse Komisioni vendosi për miratimin e rendit të ditës dhe bartjen e pikës 4 në mbledhjen e radhës me plotësimin e z. Zyba për të ndryshme si pikë të veçantë të diskutohet për vizitat e komisionit në institucionet e ndryshme.

2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja 28.1.2019

Kryetari Nitaj, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja 28.1.2019.

3. Agjenda e projektligjeve në komision që kanë kaluar në leximin e parë dhe caktimi i grupeve punuese;

Muharrem Nitaj, kryetar, njoftoi se prej projektligjeve të miratuara në leximin e parë më e rëndësishme është ai për ajrin për të cilin ky komision ka formuar grupin punues kurse ai ka biseduar me Ministrin e MMPH me të cilin është pajtuar që ky projektligj të amendamentohet brenda dy javësh. **Ganimete Musliu** propozoi që grupet punuese të fillojnë punën që nga sot pasi që edhe sesioni pranveror ka filluar me ndihmën e administratës të cilët kanë vendimet se kush është kryesues për cilin projektligj. **Andin Hoti** kërkoi listën e emrave të deputetëve ku janë caktuar si anëtarë të GP dhe përshpejtimin e projektligjit për farëra, pasi fillojnë mbjelljet. **Besa Gaxherri** tha se duhet bërë kërkesa zyrtare për këtë përshpejtim e jo të mbetet kjo kërkesë vetëm në procesverbal.

5. Përgjegjet nga OEK pas vizitës në këtë institucion

Kryetari për këtë pikë ftoi **z. Zyba dhe z. Hoti** për elaborimin e tyre nga vizita e kryer në OEK për të mar qëndrimet e duhura komisioni pas kësaj vizite të kryer. **Z. Zyba** potencoi se vizita ishte mjaft e dobishme ngase është aritur që kjo Odë të njoftohet për shqetësimet e komisionit për mallrat përkatësisht taksën e vendosur Serbisë nga Qeveria e Kosovës. Fillimisht janë parashtruar disa pyetje në të cilat zyrtarët e institucionit në fjalë janë përgjegjur. Pyetja konkrete ka qenë barkodi si identitet i produkteve si dhe janë kuptuar më mirë disa çështje që janë me rëndësi për komisionin dhe institucionet tjera të cilat mund të shërbejnë komisionit për të përfunduar interesimin për këtë çështje. Ai insistoi që komisioni të vizitonte edhe tre institucione tjera AUV, Doganën dhe MTI për

të kompletuar këtë interesim që shfaq komisioni. Edhe **Andin Hoti** në këtë frym propozoi ashtu sikurse z. Zyba vizitën në këto institucione për të sqaruar më mirë pse ndodhin këto gjëra me barkoda etj. në mënyrë që kjo do të jet një presion nga ky komision për të hulumtuar ata më mirë pse ndodhin dhe a ndodhin malverzimet apo keqpërdorimet me barkoda të mallrave. Komisioni vendosi të vizitohet MTI ditën e premte më 15.2.2019 në orën 13,00 ku do të mbahet një takim i përbashkët me zyrtarët e MTI, Doganës dhe AUV.

6. Të ndryshme

Kryetari në të ndryshme konstatoi se kërkesa e **z. Zyba** në fillim të mbledhjes veç u përmbush me caktimin e vizitës së cekur më lartë me institucionet vendore. Gjithashtu komisioni u njoftua për mundësinë e vizitës në Kroaci rreth projektligjit për mbrojtjen e ajrit, për më tepër do të njoftohet komisioni rregullisht.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Muharrem Nitaj